Në bazë të kreut VII të Nenit 35 të Statutit të "Federatës së Gjimnastikës së Kosovës'' Kuvendi i FGJK-së, aprovoi këtë:

RREGULLORE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1.

Me këtë rregullore të punës rregullohet mënyra e punës së Këshillit Mbikëqyrës të Kuvendit të Federatës së Federatës së Gjimnastikës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë Këshilli Mbikëqyrës).

Neni 2.

Sipas dispozitave të kësaj rregulloreje përgatiten, caktohen dhe mbahen mbledhjet e Këshillit mbikëqyrës të FGJK dhe realizohen autorizimet dhe obligimet e tij.

Neni 3.

Këshilli mbikëqyrës i FGJK përbëhet nga 3 anëtarë, ekspert të fushave të caktuara, të cilët i zgjedh Kuvendi.

Neni 4.

Këshilli ka Kryetarin, të cilin nga radhët e veta e zgjedhin anëtarët e Këshillit.

Neni 5.

Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjatë 4 vite me mundësi vazhdimi edhe për 1 (nje) mandat.
Mandati i anëtarëve të Këshillit mund të pushoi edhe para skadimit të mandatit në këto raste:

- Dorëheqja nga anëtari i Këshillit,
- Shkarkimi i tij,
- Me shkapërderdhjen e organizatës,
- Me vdekje,
- Në rastet tjera të parapara me Ligj dhe Statut.

II. FUSHËVEPRIMI

Neni 6.

Fushëveprimi i Këshillit mbikëqyrës të FGJK-së është:

- Mbikëqyr zbatimin e Statutit dhe të akteve tjera normative,
- Mbikëqyr gjendjen materialo-financiare,
- Mbikëqyr shfrytëzimin e pasurisë së FGJK-së,
- Mbikëqyr zbatimin e vendimeve, konkluzave dhe akteve tjera juridike.
- Kryen edhe punë tjera që ia beson Kuvendi.

III. MBLEDHJET E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË FGJK-SË

Neni 7.

Këshilli Mbikëqyrës i FGJK-së, në mbledhjet e veta nxjerr vendime, konkluzione, qëndrime, jep mendime, nis iniciativa dhe propozon zgjidhje të përshtatshme.

Neni 8.

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të FGJK-së mbahen sipas nevojës.

Neni 9.

Në mbledhjet e Këshillit mbahet procesverbali.
Procesverbali duhet të mbahet në mënyrë korrekte, ku secilit anëtar mund të i lexohet diskutimi i tij nëse e kërkon ai. Procesverbalin e nënshkruan Procesmbajtësi dhe Kryetari.

Neni 10.

Mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës e thërret Kryetari.

Neni 11.

Për mbledhje të Këshillit ftohen gjithmonë të gjithë anëtarët.

Neni 12.

Prania në mbledhje është e obligueshme. Nëse ndonjëri prej anëtarëve ka pengesa për ardhje në mbledhje, është i obliguar që të njoftoj Kryetarin.

V. PUNA NË MBLEDHJET E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Neni 13.

Këshilli Mbikëqyrës i FGJK-së punon dhe vendos në mënyrë të plotfuqishme nëse në mbledhje prezantojnë të gjithë anëtarët.

Neni 14.

Për secilën pikë të rendit të ditës bëhet shqyrtim i veçantë, dhe sipas radhitjes së miratuar.

VI. VENDIMET DHE VOTIMI

Neni 15.

Vendimet e Këshillit miratohen me shumicën e votave të anëtarëve.

VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16.

Punët administrativo-teknike për nevojat e Këshillit Mbikëqyrës i bën Sekretaria e Organizatës .

Neni 17.

Rregullorja është miratuar nga Kuvendi i FGJK-së, me datë 15/10/2022

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email:
kosovagymnasticsfederation@gmail.com